



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202301155/4

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për të garantuar mbrojtjen e fëmijës me inicialet G.B., fëmijë me aftësi të kufizuar në interesin më të lartë të tij

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

BASHKISË ELBASAN

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE

ELBASAN

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP) bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) ka regjistruar me nismën e vet rastin e bërë publik të ushtrimit të dhunës nga edukatorja ndaj fëmijës 5-vjeçar të diagnostikuar me spektrin e autizimit, në një kopësht në varësi të Bashkisë Elbasan. Organet e drejtësisë kanë filluar procedimin penal ndaj edukatores, ndërsa në një reagim për mediat përfaqësuesit e bashkisë lënë të kuptohet një lloj shfajësimi për edukatoren duke pretenduar së i miturin, fëmija 5-vjeçar është hiperaktiv dhe shfaq sjellje të dhunshme.

Referuar ligjit nr. 8454/1999, AP-ja filloi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion zyrtar lidhur me rastin në fjalë për të bërë të mundur mbrojtjen e fëmijës me aftësi të kufizuar me inicialet G.B¹.

¹ Shkresat zyrtare me nr.K5/I67-2 prot., datë 13.12.2023 dhe nr.K5/I67-3 prot., datë 16.4.2024 të institucionit të Avokatit të Popullit

Në përgjigje të shkresës së AP-së me nr. K5/I67-3 prot., datë 16.4.2024, “Kthim përgjigje” Bashkia Elbasan ka sqaruar si më poshtë vijon:

‘Bashkia Elbasan përmes Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës dhe në bashkëpunim me aktorët lokalë po menaxhojnë rastin e fëmijës G.B. që pretendohet se është dhunuar nga edukatorja O.B. e këtij kopshti.

Në këtë kontekst bazuar në ligjin nr.18/2017 ‘Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës’, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.578 datë 03.10.2018 ‘procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimi dhe përmbajtja e planit individual të mbrojtjes’, është thirrur Grupi Teknik Ndërsektorial pjesë e të cilit janë aktorë si Policia e Shtetit, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, Shërbimi Psiko-Social i Arsimit, Shëndetësia, shoqatat që kanë në fokus fëmijët dhe përfaqësues të kopshtit nr.1 (drejtoresha, edukatorja) terapistja që ndjek fëmijën dhe prindi, sipas parashikimeve të VKM-së së lartpërmendur, specifikisht nenet 26,27 të këtij vendimi. Grupi Teknik Ndërsektorial, në mungesë të provave, konkretisht, shenja në trup, ndryshime në sjellje të fëmijës dhe fëmijëve të tjerë të grupit si rezultat i dhunës që mund të jetë ushtruar, vendosi krijimin e Komisionit të Vlerësimit të përbërë nga Eriona Hoxha, Jonida Mustafaraj, Ina Danaj psikologe klinike, Iris Debroya psikologe shkollore, Bora Dybeli, Besnik Toska punonjës social, Elidiona Çelaj logopede profesioniste të cilat janë pjesë të stafeve të shërbimeve psiko/-sociale në shëndetësi dhe arsim.

Përfshirja e tyre në këtë proces është bërë me delegim nga drejtuesit e institucioneve përkatëse bazuar në kërkesën e bërë nga bashkia Elbasan por në kontekstin e VKM-së të cituar më lart dhe duke pasur në konsideratë fushën e zbatimit të kësaj VKM-je: përcaktimet e këtij vendimi janë të detyrueshme për të gjithë autoritetet shtetërore, mekanizmat këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor, institucionet publike apo private, organizatat jofitimprurëse dhe të gjithë personat e tjerë, të cilët kanë për detyrë funksionale, profesionale, kontraktuale apo ligjore të kryejnë referimin, menaxhimin, koordinimin apo të ofrojnë një shërbim, në kuadër të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Raporti i cili pati në fokus vlerësimin e situatës së fëmijës me inicialet G.B., të fëmijëve të tjerë të grupit, të edukatores që pretendohet se ka dhunuar fëmijën, prindërve të fëmijës dhe të fëmijëve të tjerë të grupit ku bën pjesë fëmija, doli në përfundimin e mëposhtëm:

1. *Edukatorja me inicialet O.B., nuk ka pasur në asnjë moment qëllim lëndimin fizik të fëmijës me inicialet G.B., ose të ndonjë fëmije tjetër të grupit të dytë të kopshtit nr.1.*
2. *Skema ku edukatorja ka mbajtur fëmijën me inicialet G.B., para vetes, nuk e la lejuar të lëvizë dhe ka thirrur fëmijët e tjerë të grupit që ta gjuajnë, ka ndodhur. Këtë e referojnë fëmijët dhe e tregojnë me të gjithë elementët ngjarjen.*
3. *Për shkak të fëmijëve që kanë diagnozë në atë grup dhe specifikisht për shkak të hiperaktivitetit të fëmijës G.B. dhe sjelljeve të tij të pamëshueshme, puna për procesin mësimor, në atë grup është thuajse e pamundur. Ndaj vlerësojmë se duhet mësuese mbështetëse çdo ditë, jo vetëm 3 herë në javë ose një shoqërues për fëmijën për të gjitha orët që ai qëndron në kopsht.*
4. *Nuk ka shënja traume te fëmijët, por duhet punuar me ta sepse janë mësuar me zhurmë dhe mungesën e rregullit dhe kjo mund të bëjë që më vonë, të mos dallojnë të mirën nga e keqja, të drejtën nga e gabuara.*
5. *Mendojmë se nuk do ishte në interesin më të lartë të të miturëve që edukatorja të kthehej dhe të jepte mësim në atë grup. Kjo do të shkaktonte shumë problematika që nuk do të ishin në gjendje më pas t'i zgjidhnin as instanca të ndryshme institucionale.*

Lidhur me situatën e fëmijës informojmë se fëmija është i qetë, nuk ka ndryshime të sjelljes, vazhdon të frekuentojë kopshtin nr.1, ndjek rregullisht seancat terapeutike pranë qendrës “i dëgjoj 366”.²”

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton “mbrojtjen nga diskriminimi mbi bazën e gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare e filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore” dhe përcakton se mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga diskriminimi bëhet për shkak të gjendjes së tyre sociale. Gjithashtu Kushtetuta parashikon arsimimin dhe kualifikimin, sipas aftësive të fëmijëve dhe të rinjve: e). *përkujdesjen dhe ndihmën për personat me aftësi të kufizuara; f). riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të njerëzve me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës .*

² Shkresa zyrtare me nr. 265/1 datë 25.01.2024 të Bashkisë Elbasan.

Neni 7, i Konventës së Kombeve të Bashkuara, “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, thekson detyrimin e shteteve palë për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë të gjithë të drejtat dhe liritë njësoj si fëmijët e tjerë. Shtetet duhet të përkujdesen veçanërisht për respektimin e të drejtave të fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe kur merren vendime për ta, të vlerësojnë seriozisht atë që thonë fëmijët.

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (1989) mbron të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në nenin 23 të saj. Gjithashtu, duhet të kujtojmë se në radhë të parë fëmijët me aftësi të kufizuara janë fëmijë. Ata, njësoj si fëmijët pa aftësi të kufizuara, kanë të drejtën për të qenë të lirë nga dhuna dhe të drejtën të respektohen dhe të mbrohen.

Bazuar në përgjigjet zyrtare të sipërcituara dhe të Vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, (VKM nr.578/2018) AP-ja konstaton se:

- NJMF-ja në Bashkinë Elbasan ka filluar punën për menaxhimit të rastit të fëmijës me inicialet G.B., duke thirrur Grupin Teknik Ndërsektorial (GTN) për të kryer vlerësimin e plotë lidhur me dyshimet e pretenduara nga prindi i fëmijës me inicialet G.B., për ushtrimin e dhunës nga edukatorja O.B. Për mungesë të provave konkrete të ushtrimit të dhunës (shenjave në trup, ndryshimi i sjelljes së fëmijës etj) GTN-ja ka marrë vendimin e krijimit të **Komisionit të Vlerësimit** me përfaqësues të organeve të administratës publike në nivel vendor në arsim, shëndetësi, shërbime sociale, organizata jo-qeveritare në profesionet, “psikolog klinik”, “psikolog shkollor”, “punonjës social” etj me qëllim vlerësimin fillestar të riskut të fëmijës me inicialet G.B sipas ankesit 2, të VKM-së nr.578/2018³;

³Rrezik i menjëhershëm *Shpjegim. Në rrezik të menjëhershëm konsiderohet situata në të cilën gjendet fëmija, i cili në momentin e identifikimit, nuk ka aftësi vetëmbrojtëse dhe nëse lihet në rrethanat aktuale, pa asnjë ndërhyrje mbrojtëse apo kujdes shëndetësor, mund të vdesë, të dëmtohet ose të plagoset rëndë, të abuzohet seksualisht, trafikohet apo të jetë pre e keqtrajtimit të tjera të konsideruara vepër penale sipas Kodit Penal. Ndërhyrja në këtë rast duhet të jetë urgjente dhe të sigurojë largimin e fëmijës nga situata e rrezikut.* □ Rrezik i lartë *Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili për shkak të faktorëve të ndryshëm, rrezikon që të dëmtohet rëndë, të jetë subjekti i llojeve të ndryshme të abuzimit në mënyrë të vazhdueshme apo të dëmtohet në mënyrë të tillë që të vuajë nga paafësi të përhershme apo t'i rrezikohet seriozisht mirëqenia nëse nuk merren masa për të mbrojtur fëmijën.* □ Rrezik i mesëm *Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, për të cilin nuk ka të dhëna që të jetë në rrezik për të pësuar dëmtime të rënda apo të ketë pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia që fëmija të dëmtohet apo të abuzohet, nëse nuk merren masa për ta mbrojtur atë. Ndërhyrja për të mbrojtur fëmijën dhe për të ofruar shërbime është e domosdoshme.* □ Rrezik i ulët *Shpjegim. Është situata në të cilën gjendet fëmija, i cili është relativisht i sigurt, nuk vuan nga dëmtime që kanë ardhur si*

- referuar përfundimeve të raportit të **Komisionit të Vlerësimit**, vlerësimi i nivelit të rrezikut është “rrezik i ulët”, pasi fëmija me inicialet G.B., është relativisht i sigurt situata e fëmijës pas incidentit është e qetë, ai nuk ka dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e dhunës (ai *nuk ka ndryshime të sjelljes vazhdon të frekuentojë kopshtin nr.1, ndjek rregullisht seancat terapeutike pranë qendrës ‘Dëgjoj 366’⁴*). Megjithatë, vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e dhunës, nëse nuk realizohen ndërhyrje për t’i ofruar aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet për të cilat fëmija ka nevojë. Në grupin e kopshtit nr.1, ku zhvillon procesin e edukimit fëmija me inicialet G.B., ka dhe fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuar të cilët nuk janë vlerësuar nga Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar pranë Zyrës Vendore Arsimore Elbasan për të ofruar mbështetjen me mësues ndihmës. Kjo, si rezultat i faktorëve të ndryshëm ndër të cilët mund të përmendim mosdiagnostikimin e hershëm të këtyre fëmijëve, mospranimin e aftësisë së kufizuar të fëmijëve nga vetë prindërit e tyre etj. Fëmijët e kopshteve janë më të hapur dhe pranues të luajnë dhe të mësojnë së bashku por mungesa e mësuesëve ndihmës bazuar në numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar vështirëson jo vetëm marrëdhëniet mësimore dhe sociale me këta fëmijë, por shpesh edhe me prindërit e tyre që jo rrallë ngatërrojnë mungesën e dijeve të edukatorëve me ndjenjën e përgjegjësisë së tyre të cilët e konsiderojnë të ulët, me paragjykitime dhe shpesh edhe të dëmshme për zhvillimin e fëmijëve të tyre. Edukatorët duhet të planifikojnë dhe modifikojnë aktivitete në varësi të nevojave që kanë fëmijët në fushën e nxënjes, si dhe duke konsideruar pikat e forta të çdo fëmije, përfshi edhe ata me aftësi të kufizuar.

AP-ja vlerëson fillimin e punës të NJMF-së në Bashkinë Elbasan, sipas nenit 5, të VKM nr.578/2018, dhe përfundimin e vlerësimit fillestar të rastit të fëmijës me inicialet G.B., duke marrë të mirëqenë që janë duke hartuar Planin Individual të Mbrojtjes (PIM). Sjellim në vëmendje se veprimet e kryera nga edukatorja me inicialet O.B., në mbajtjen e fëmijës me inicialet G.B., para vetes dhe thirrja drejtuar fëmijëve të tjerë për të gjuajtur këtë fëmijë janë veprime detyruese që kanë sjellë ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike ndaj fëmijës me inicialet

rrjedhojë e abuzimit dhe ka aftësi për të mbrojtur veten. Megjithatë, vlerësohet se ka prezencë të faktorëve të rrezikut dhe se fëmija mund të bëhet pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit, nëse nuk realizohen ndërhyrje për t’i ofruar respektimin dhe aksesin në të drejta apo nëse nuk i ofrohen shërbimet për të cilat fëmija ka nevojë

⁴ Bazuar në paragrafin e fundit të shkresës zyrtare me nr. 265/1 datë 25.01.2024 të Bashkisë Elbasan

G.B nga fëmijët e tjerë të grupit të dytë të kopshtit nr.1, Elbasan. Kjo bazuar në pikën 3, të nenit 3, të ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” sipas të cilit “...“Dhunë ndaj fëmijës” është çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual””.

AP-ja thekson se kjo situatë është edhe më e rëndë pasi krijon diskriminim dhe dhunë midis fëmijëve me njëri-tjetrin.

Bazuar në pikën 5, të nenit 107, të Urdhërit nr.31, datë 28.1.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”(Urdhëri nr.31/2020) “*në rast se kur mësuesi/nëndrejtori ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve apo punonjësve në institucion dhe këto veprime janë të provuara, jepet masë disiplinore “largim nga puna” përveç veprimeve të tjera që mund të ndiqen nga strukturat kompetente sipas legjislacionit në fuqi”*”.

Në vijim, AP-ja tërheq vëmendjen e Komisionit të Vlerësimit për gjetjen nr.1, në raport. Qasjen shfajësuese ndaj edukatores në këtë gjetje, e vlersojmë si një element që nuk plotëson standardin e interesit më të lartë të fëmijës, i cili nënkupton *të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:*

- a) *nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;*
- b) *mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;*
- c) *historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;*
- ç) *aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;*
- d) *vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore⁵.*

⁵ Pika 3, e nenit 6, të ligjit nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve ka theksuar në Komentin e Përgjithshëm nr. 8 që të gjitha format e ndëshkimit trupor janë poshtëruese. Ndëshkimi trupor duhet të ndalohej jo vetëm në shtëpi, por edhe në mjedise të tjera, si p.sh qendrat e kujdesit, shkollat, klubet sportive, shërbimet mbështetëse dhe institucionet.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga AP-ja në përgjigjen zyrtare të Bashkisë Elbasan lidhet me edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët ndodhen në grupin e dytë të kopshtit nr.1 në Bashkinë Elbasan. Këta fëmijë kanë nevojë për përkujdesje të veçantë dhe për mësues ndihmës.

Bazuar në nenin 38, të Urdhërit nr.31/2020 komisioni i institucionit arsimor për fëmijët me aftësi të kufizuar, në kopshtin nr.1, Elbasan duhet të rivlerësojë Planin Edukativ Individual, (PEI) të fëmijës me iniciale G.B., dhe t'i propozojë Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar pranë Zyrës Vendore Arsimore Elbasan vendosjen e mësuesit ndihmës çdo ditë për këta fëmijë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë. Duke pasur të njëjtat mundësi për të përparuar si çdo fëmijë, ata kanë potencialin të kenë një jetë të përmbushur dhe të denjë, si dhe të kontribuojnë në gjallërinë sociale, kulturore dhe ekonomike të komuniteteve të tyre.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga format më të mira të arsimit për të gjithë fëmijët. Është e drejta e çdo fëmije të arsimohet në shkolla dhe të trajtohet me dinjitet. Mësimdhënia duhet t'i përshtatet specifikave, nevojave dhe mundësive të çdo fëmije. Institucionet e edukimit (kopshte, shkolla) janë të njëjta për të gjithë fëmijët dhe për vijimin e saj, të gjithë kanë shanse të barabarta, pavarësisht nga aftësitë që ka gjithësecili.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të brendshëm, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e edukimit dhe mbrojtjes së fëmijës, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999 AP-ja:

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga Bashkia e Elbasanit për dhënien e masës disiplinore “*largim nga puna*” për edukatoren me inicialet O.B., bazuar në pikën 5, të nenit 107, të Urdhërit nr.31, datë 28.1.2020 të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.
- Marrjen e masave nga komisioni i institucionit arsimor për fëmijët me aftësi të kufizuar, në kopshtin nr.1, Elbasan për rivlerësimin e PEI-it të fëmijës me G.B., dhe dërgimin e propozimit Komisionit të Vlerësimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar pranë Zyrës Vendore Arsimore Elbasan për prezencën e një mësuesi ndihmës çdo ditë për fëmijën me inicialet G.B.
- Marrjen e masave nga Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar në Zyrën Vendore Arsimore Elbasan për rivlerësimin e nevojave të fëmijëve të gjithë me aftësi të kufizuar për mësues ndihmës në kopshtin nr.1 Elbasan⁶.
- Marrjen e masave për vlerësimin vjetor në rang bashkie për mësues ndihmës në varësi të numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe buxhetimin afatshkurtër dhe afatmesëm për plotësimin e detyrimit ligjor në lidhje me mësuesit ndihmës.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ

⁶ Bazuar në Urdhërin nr.26, datë 25.11.2019 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”